

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"CARBON 4" SHPK**

**KREU I**

**Dispozita te Pergjithshme**

Sot, në datën 13.08.2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë) personat e mëposhtem:

- **Z. Avni KRASNIQI**, atesia Smajl, i datëlindjes 07.08.1970, lindur ne Turjak dhe banues ne Rrugen "Beteja e Pozharit" Pejë, Kosovë, shtetas Austriak, madhor, me zotësinë e plotë për të vepruar, mbajtës i Pasaportes Austriake Nr. AUT P 4166982;

dhe

- **Z. Genc DRITA**, atesia Ramazan, i datëlindjes 21.03.1974, lindur ne Shalqize, Tirane dhe banues ne Berzhite Tiranë, shtetas Shqiptar, madhor, me zotësinë e plotë për të vepruar, mbajtës i Leternjoftimit nr. Personal H40321214];

në cilësinë e "Ortakëve Themelues", me vullnet te lire te plote e te singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, Kodin Civil ne fuqi, ligjin Nr. 9901 date 04.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" dhe ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", vendosën te themelojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin **"CARBON 4" SHPK**.

**KREU II**

**Ortaket, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Zyra Qendrore**

**Neni 1**

**Emri dhe Ortaket**

- 1.1 Shoqeria eshte e organizuar dhe funksionon sipas formes "shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" dhe mban emrin **"CARBON 4" SHPK**.
- 1.2 Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga ortakët në shoqëri.

**Neni 2**

**Objekti**

Shoqëria **"CARBON 4" SHPK** ka si objekt të veprimtarise te saj, zhvillimin e aktiviteteteve si me poshte te percaktuara:

- Specializim ne zhvillimin e ngrohjes inovative. Teknika e ngrohjes me rreze te kuqe ne sektorin e ngrohjes; Import dhe eksport paisjesh te lidhura me keto sisteme, shitje me shumice dhe pakice dhe cdo aktivitet tjeter te lidhur me keto.
- Ne fushen e prodhimeve te drurit, tregtim me shumice e pakice te ketyre prodhimeve lendeve te para per prodhim druri, tregtim lendesh drusore, import eksport, punimi i vilave te drurit, si dhe çdo veprimtari tjeter qe ka lidhje me lendet drusore.




- Ndërtim të banesave civile, industriale, monumentale, kompletim të impianteve dhe përfundim të tyre; vepra restaurimi; ndërtim të asfaltit; të aeroporteve dhe hekurudhave; të galerive; të urave, të digave, vepra speciale të betonuara, punime hekurudhore, punime hidraulike; ujësjellësi; gazsjellsi; vajgursjellsin, mbrojtjeje dhe sisteme hidraulike, agrare, pyjore, punime detare dhe të portit, impiante të mbarështrimit, të pastrimit të ujit të pijshëm, realizimit të impianteve të trajtimit të plehrave; realizimit të impianteve teknologjike dhe speciale për ndërtimin, realizimin e karpenterisë metalike; realizimin e impianteve për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë; zbulime; eksplorime të nëntruallit, rregullim të terreneve dhe shpim pusesh. Shoqëria do të kryejë punë për ndarjen në parcela dhe të urbanizimit në përgjithësi, projektimit, llogaritjeve statike, drejtim punësh si dhe të veprave si koordinuese teknike dhe administrative me sipërmarrje të tjera; të tregtojë dhe të prodhojë me shumicë detale të çfarëdo lloj materiali në përgjithësi për ndërtimin; sjelljen e pajisjeve dhe atrecaturave për kantiere, të kryejë blerjen, shitjen, ndërtimin, administrimin dhe shkëmbimin e pasurisë së palëvizshme. Ajo mund të kryejë përveç të gjitha veprimeve tregtare, financiare dhe kreditore, të tundshme dhe të patundshme, edhe qiramarrjen nëse është e nevojshme dhe e mundshme për vazhdimin dhe realizimin e qëllimit të shoqërisë. Dhënie ambientesh e objektesh me qira, si pasuri të luajtshme edhe të paluajtshme. Blerje-shitje pasuri të paluajtshme e të luajtshme. Veprimtari tregtare në fushën e ushqimit social, hoteleri, turizëm, shitje materiale ndërtimi.

- Import-export dhe tregti me shumicë dhe pakicë i të gjitha mallrave industriale, ushqimore, elektroshtepiake, mekanike dhe elektromekanike, pajisje telekomunikacioni, automjeteve, pjesë këmbimi për automjete, pajisje elektrike, hidraulike dhe duralumini, pajisje hidrosanitare, prodhime bujqesore e blegtorale, të sinjalistikës rrugore, si dhe çdo lloj malli/prodakti tjetër të lejuar nga legjislacioni shqiptar dhe nderkombëtar.

- Menaxhimin për llogari të vet dhe / ose të të tretëve të rrjeteve ose zinxhirëve të hoteleve, apartamenteve për pushime, restoranteve, bareve dhe snack bareve, picerive, bareve rostiçeri, pastiçerive dhe dyqaneve të bukës, picerive, fast food-ve, garnì (hotele vetëm me shërbim mëngjezi), strehave malore, kamping-jeve, piano bar, diskove, lokaleve të natës, lokaleve argëtuese, sallave të lojrave, diskove pub, rezidencave turistike hotelerish dhe në përgjithësi ushtrime publike në fushën e shërbimit dhe të sektorit hoteleri turizëm, të organizuara dhe të lidhura duke përdorur mënyra të tilla si franchising (praktika të përdorimit të modeleve të sukseshme të biznesit), aleanca strategjike dhe tregtare, filiale (ortakëritë), partneritete, sipërmarrje të përbashkëta dhe çdo mjet të mundshëm që finalizojnë krijimin e rrjeteve apo grupeve të kompanive në nivel kombëtar dhe nderkombëtar;

- Ofrimi i shërbimeve në fushën e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, vlerësimin e pasurive të paluajtshme, shërbime konsulence dhe tregtare si dhe perfaqësim të të treteve në fushën e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme, ndërmjetësim dhe shitje me shumicë dhe pakicë të çdo lloj pasurie të luajtshme dhe të paluajtshme, dhenien me qira apo në përdorim të tyre, investime në fushën e pasurive të paluajtshme në përgjithësi dhe veprimtari ndihmëse të lidhura me të, bashkëpunimi me subjekte të tjera të fushës brenda dhe jashtë



territorit te Republikes se Shqiperise, blerje, shitje, permiresim, administrim dhe zhvillim te pasurive te paluajtshme si dhe çdo aktivitet tjeter te ligjshem ne lidhje me sa me siper.

- Pjesëmarrja e shoqerise ne tendera, koncesione apo ne cdo procedure tjeter konkurimi kombetar apo nderkombetar, vetem apo ne bashkepunim me subjekte te tjere pa kufizim persa i perket objektit sa me siper.

### Neni 3

#### Kohëzgjatja

3.1 Shoqëria do te ushtroje aktivitetin e saj per nje afat te pakufizuar, me perjashtim te rastit kur Asambleja e Ortakeve, sipas kuorumit perkates vendos ndryshe.

3.2 Shoqeria "CARBON 4" SHPK gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tille ne regjistrin tregtar te QKR-se.

### Neni 4

#### Zyra Qendrore

4.1 Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri ndodhet ne adresën: **Tiranë, Berzhite, IBE Njësia Administrative Berzhite, Rruga Tiranë Elbasan, Km 18, Fshati Ibe, Nr. Pasurie 44/13, Zona Kadastrale 1977, Vol 4, Faqe 21.**

4.2 Gjate veprimtarise se saj, shoqeria ka te drejte te krijojë dhe hape dege, filiale dhe/ose zyra perfaqesimi edhe ne qytete te tjera, brenda dhe/ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me legjislacionin e kerkuar ne fuqi sipas juridiksionit te vendit perkates.

### KREU III

#### Neni 5

#### Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

5.1 Kapitali i regjistruar i shoqerise është **100.000 Lekë** (njqindmije lekë), i barabarte me 2 (dy) kuota. Kontributet e ortakëve themelues perbejne kapitalin e regjistruar te shoqerise.

5.2 Pjesëmarrja e ortakëve themelues në kapitalin e shoqërisë janë ne raport me kontributin e derdhur prej tyre dhe vlera nominale e kuotes se tyre, e cila llogaritet ne raport me kontributin te paraqitur ne menyre te permbledhur sipas grafikut te meposhtem:

Nr.	Emri i Ortakut	Kuota	Kontributi i ortakut ne kapital (leke)	Perqindja ne kapital
1.	<b>Avni KRASNIQI</b>	<b>1</b>	<b>60.000</b>	<b>60%</b>
2.	<b>Genc DRITA</b>	<b>1</b>	<b>40.000</b>	<b>40 %</b>
	<b>TOTAL</b>	<b>2</b>	<b>100.000</b>	<b>100 %</b>



- 5.3 Kontributet sa me siper jane nenshkruar dhe shlyer plotesisht nga ana e ortakëve themelues te shoqerise.

#### **Neni 6**

#### **Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar**

6.1 Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave të ortakëve në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.

6.2 Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar te shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave (tre të katërtat) në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit, duke pasur parasysh qe te respektohet minimumi i parashikuar nga Ligji per Shoqerite Tregtare.

#### **KREU IV**

#### **Neni 7**

#### **Kuotat dhe Transferimi i Kuotave**

7.1 Transferimi (përfshire shitje dhe ose dhurimin dhe ose cedimin dhe ose kalimin) inter vivos te kuotave te shoqerise tek pale te treta i nenshtrohet te drejtes se parablerjes ne favor te ortakëve te tjere ekzistues, te cilet mund ta ushtrojne kete te drejte sipas kushteve te parashikuara ne nenin 7.2 me poshte.

7.2 Ne rast se nje ortak (ketej e tutje i quajtur Ofruesi) kerkon te transferoje disa ose te gjitha kuotat ose kontributet e zoteruara prej tij ne shoqeri, ortakët e tjere (ketej e tutje te quajtur Ortaket e tjere) gezojne te drejten e parablerjes mbi kuotat qe ofrohen per transferim (ketej e tutje te quajtur Kuotat e ofruara), sipas afateve dhe kushteve te meposhtme:

- a. Ofruesi do tu dergoje fillimisht ortakëve te tjere ekzistues nje njoftim me shkrim (poste rekomande) ku te percaktohet numri i kuotave te ofruara, si dhe çmimin e kuotave te ofruara, emrin e bleresit dhe kushtet e tjera kontraktuale te transferimit (ketej e tutje referuar si oferta) duke ftuar se pari ortakët ekzistues te blejne keto kuota te ofruara.
- b. Ortaket e tjere kane te drejte te blejne kuotat e ofruara sipas kushteve te ofertes, ne perpjestim me perqindjet e zoteruara e zoteruara, duke i derguar nje njoftim me shkrim ofruesit brenda nje afati 30 ditor pas marrjes se njoftimit te ofruesit me poste rekomande.

7.3 Ne rast se nje apo disa nga ortakët ekzistues nuk pergjigjen gjate afatit te mesiperme apo pergjigjen ne menyre negative, atehere ofruesi eshte i lire ne transferimin e kuotave ne favor te paleve te treta pa kufizim, me kushte te njejta si ato te parashikuara ne oferten e mesiperme.

7.4 Parashikimet sa me siper nuk zbatohen ne rastin kur kuotat transferohen ndermjet ortakëve ekzistues apo tek personat e paralindur apo paslindur ne vije te drejte te ortakëve ekzistues (femije, bashkeshorte).

#### **Neni 8**

#### **Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit**



**8.1** Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët e tij do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.

**8.2** Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortakut do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në QKB.

#### **Kreu IV**

### **Asambleja e Përgjithshme**

#### **Neni 9**

#### **Kompetencat dhe Thirrja e Asamblese se Pergjithshme**

**9.1** Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme do të vendosë, por pa u kufizuar, për çështjet e mëposhtme të Shoqërisë:

- a. percaktimi i politikave tregtare;
- b. ndryshime të Statutit;
- c. emerimi dhe shkarkimi i administratorit/administratoreve;
- d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel të autorizuar;
- e. miratimi i skemës së shperblimeve për personat e përmendur në shkronjat c. dhe d.;
- f. mbikeqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga ana e administratorit/administratoreve, duke përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve mbi ecurinë e aktivitetit të Shoqërisë;
- g. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve mbi ecurinë e aktivitetit të Shoqërisë;
- h. zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit;
- i. pjesëtimi i kuotave dhe anulimi i tyre;
- j. perfaqesimin e shoqërisë në gjykime dhe në procedime të tjera kundër administratorit/administratoreve të saj;
- l. riorganizimi dhe prishja e Shoqërisë;
- m. miratimi i rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- n. çështje të tjera të parashikuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare dhe Statuti.

Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortakut i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Nëse ortakut i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëherë ortakut përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht.

- 9.2 Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e përmendura në pikat (g) dhe (h) me sipër pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes së asamblese së përgjithshme.
- 9.3 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratori apo ortakët e minorances sipas dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare në fuqi nëpërmjet një njoftimi me shkresë, me postë ose e-mail drejtuar çdo ortakut, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 (shtatë) ditë të plota përpara datës së caktuar për mbledhjen përveç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga të gjithë ortakët që zotërojnë 100% të kapitalit të shoqërisë.
- 9.4 Njoftimi për thirrjen e Asamblese duhet të përmbajë në mënyrë të qartë datën, ditën, kohën, vendin dhe rendin e ditës të mbledhjes, së bashku me dokumentacionin përkatës dhe do t'u dërgohen të gjithë Ortakëve të Shoqërisë të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes.

Në rast ndryshimi të rendit të ditës, do të ndiqet e njëjta procedurë njoftimi që përshkruhet më sipër.

#### **Neni 10**

##### **Kuorumi i nevojshëm**

- 10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë 31 për qind të kapitalit të shoqërisë.
- 10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë jo më pak se 75 për qind të kapitalit të shoqërisë.
- 10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 11**

##### **Marrja e vendimeve**

- 11.1 Asambleja e Ortakëve vendos me aprovimin e ortakëve që zotërojnë 75% të kapitalit të shoqërisë me të drejtë vote, për çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.
- 11.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera të zakonshme si :
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve;

d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

**11.3** Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

**11.4** Kryetari i mbledhjes së asamblese së përgjithshme do të jete administratori i shoqërisë i cili do të drejtojë mbledhjen dhe asambleja e përgjithshme në çdo mbledhje të saj do të emerojë me shumicë të thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës edhe një person tjetër për të mbajtur proces-verbalin e mbledhjes së asamblese së përgjithshme.

**11.5** Çdo vendim i mbledhjes së asamblese së përgjithshme do të regjistrohet në proces-verbal, i cili do të mbahet në perputhje me nenin 90 të ligjit Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

## **Neni 12**

### **Votat e Ortakëve**

**12.1** Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit për shoqëritë tregtare në fuqi.

**12.2** Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

## **Kreu V**

### **Administratori**

## **Neni 13**

### **Emërimi i Administratorit**

**13.1** Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicën e votave të ortakëve në Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.

**13.2** Personi i mëposhtëm caktohet si administrator i parë i shoqërisë "CARBON 4" SHPK: **Z. Avni KRASNIQI**, atesia Smajl, i datëlindjes 07.08.1970, lindur në Turjak, Pejë, Kosovë dhe banues në Rrugen "Beteja e Pozharit" Pejë, Kosovë, shtetas Austriak, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Pasaportes austriake nr. AUT P 4166982, për një afat

**5 vjecar, nga momenti i regjistrimit te ketij akti pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit(OKB).**

**Neni 14**

**Kompetencat e Administratorit**

**14.1** Politikat tregtare të shoqërisë si dhe aktiviteti normal i saj do të administrohen nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sa me sipër dhe ligjit tregtar në fuqi.

**14.2** Pa u kufizuar sa me sipër, në mënyrë të veçantë, Administratori ka këto kompetenca:

- (i) do të drejtojë dhe të përfaqësojë Shoqërinë përpara i përket administrimit të zakonshëm;
- (ii) do të nënshkruajë çdo marrëveshje në emër të Shoqërisë;
- (iii) do të hapë llogari në emër të Shoqërisë me çdo bankë që kryen aktivitet në Shqipëri ose jashtë saj,
- (iv) do të urdherojë dhe kryejë pagesa në emër të Shoqërisë - duke nënshkruar dokumentet / instrumentet e pagesave;
- (v) do të kujdeset për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të Shoqërisë;
- (vi) do të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ia paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme;
- (vii) do të krijojë një sistem monitorimi dhe paralajmërimi njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcenojnë ekzistencën e Shoqërisë;
- (viii) do të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas kërkesave të Ligjit nr. 9723, datë 3 Maj 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- (ix) do t'i raportojë Asamblesë së Përgjithshme për zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
- (xii) do të marrë në punë, emerojë, shkarkojë të punësuar të Shoqërisë për çdo nivel, përfshirë edhe të punësuar me kohë të pjesshme, konsulentë, agjente, do të përcaktojë kompetencat dhe detyrat e tyre, si dhe do të përcaktojë shpërblimin e tyre;
- (x) të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, duke pasur parasysh respektimin në çdo rast të kufizimeve të parashikuara nga ky Statut, si dhe detyrat e dhena me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Asambleja e përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sa më sipër, ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjit ose të statutit dhe/ose padi të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

**Neni 15**

**Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit**



Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
3. ndodhet ose mund të ndodhet në kushtet e pa-afetise fizike;
4. jep doreheqje nga detyra duke njoftuar shoqerine;
5. rast vdekjeje;
6. ndodhet në situata apo rrethana të cilat e bëjnë të pamundur ushtrimin e detyrave të tij;

## **Neni 16**

### **Kufizimet në Veprimet e Administratorit**

**16.1** Administratori nuk do të lidh marrëveshje për çështje në të cilin ai ka, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit për shoqëritë tregtare, deri në momentin kur Asambleja e Përgjithshme e shoqërie, në bazë të kuorumit të kërkuar, autorizon lidhjen e kësaj marrëveshje.

**16.2** Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

## **Kreu VI**

### **Prishja dhe njoftimet**

## **Neni 17**

### **17.1 Shkaqet e prishjes së shoqërisë**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i përzemësueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 të ligjit për shoqëritë tregtare;
- d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

- 17.2** Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.
- 17.3** Administratori është i detyruar të regjistrojë prishjen e Shoqërisë në QKR, me përjashtim të rastit kur prishja bëhet me vendim gjykate; në këtë rast është gjykata që i dërgon njoftimin QKR-se.

## **Neni 18**

### **Njoftimet**

- 18.1** Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin. Administratori është i detyruar të administrojë të dhenat e ortakëve (nr.tel, email, adrese banimi etj) në një regjister të posaçëm dhe ortakët janë të detyruar të njoftojnë gjithmone administratorin për çdo azhurnim të këtyre të dhenave brenda ditës, në të kundërt mbajnë përgjegjësi për demin e shkaktuar.
- 18.2** Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike që i është njoftuar shoqërisë nga ortaku. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepën përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

## **Neni 19**

### **Te Ndryshme**

- 19.1** Te gjitha marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen me Kodin e Punes dhe çdo akt tjetër ligjor dhe nënligjor të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, në fuqi dhe në veprim kohe pas kohe gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit të saj tregtar.
- 19.2** Viti financiar zgjat 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 19.3** Në fund të çdo viti financiar, Administratori harton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, të cilet i dërgohen për miratim Asamblesë së zakonshme.
- 19.4** Për të gjitha ceshtjet që nuk janë parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në fuqi, të azhurnuar.

## **NENI 20**

### **Dispozita përfundimtare**

- 20.1** Ky statut perben dokumentin e vetëm të shoqërisë që parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarisë së shoqërisë. Ky Statut mund




te ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjeserisht ose teresisht dhe te zevendesohet me nje statut te ri vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve sipas shumices se cilesuar te percaktuar me siper.

**20.2** Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, ortaket do ti referohen legjislacionit tregtar Shqiptar ne fuqi si dhe praktikave tregtare ne vend.

Ky statut u redaktua ne 4 (kater) ekzemplare, me permbajtje dhe vlera te njeje juridike, ne gjuhen Shqip dhe u nenshkrua nga ortaku themelues pa asnje rezerve.

**Ortakët Themelues:**

**Avni KRASNIQI**

AVNI KRASNIQI  


**Genc DRITA**

Genc Drita  
